



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe neni 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parshtruar nga parashtgues anonim në vazhdimin e seancës së 50-të, të mbajtur më 22.07.2021, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Veprimi i KSHPK - së sipas lëndës së formuar pas dononcimit numër 12-3942 / 1 të datës 18.11.2020 e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga parashtgues i panjohur - grup punonjësish, që tregon se në Entin Kombëtar Qendra për Kulturë ----- caktohet i njëjti ushtrues detyre drejtor për herë të katërt ose të pestë në kundërshtim me rregullat ligjore.

Në përputhje me dispozitatë e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, pas kontrollimit të përmbajtjes së denoncimit dhe dokumentacionit shtesë, përcaktoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës për arsye se veproi dhe mori masa organi kompetent me të cilën është tejkaluar situata së cilës i referohet denoncimi.

Lënda me numër 12 -3942/1 të datës 18.11.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-3942 / 1 të datës 18.11.2020 u formua në bazë të denoncimit nga parashtgues i panjohur - grup punonjësish.

Në denoncim tregohet se në Entin Kombëtar Qendra për Kulturë ----- caktohet i njëjti drejtor i përkohshëm për herë të katërt ose të pestë në kundërshtim me rregulloret ligjore, sipas të cilave ai mundet dy herë në gjashtë muaj.

Për arsye të kontrollimit të pohimeve dhe përcaktimin e plotë të gjendjes faktike në lëndën e hapur, KSHPK kontrolloi situatën aktuale dhe historinë e ndryshimeve në EK Qendra për Kulturë - ----- dhe iu drejtua Ministrisë së Kulturës të RMV-së me kërkesë për të

dorëzuar informacion në lidhje me pohimet nga denoncimi, si dhe arsytet pse drejtori i institucionit të përmendur nuk u zgjodh në shpalljen publike.

Nga ana e Ministrisë së Kulturës, brenda afatit të përcaktuar me ligj, është dorëzuar njoftim me të cilën e informon KSHPK - në se në përputhje me Ligjin për Kulturë më datë 26.01.2021 ishte shpallur shpallje publike për zgjedhjen e drejtorit të EK Qendra për Kulturë ----- Shtip. Pas procedurës së kryer nga komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjen e drejtorit, Ministri mori aktvendim për zgjedhjen e drejtorit, që ishte dorëzuar në shtojcë për njoftim, i cili ndryshim është i dukshëm edhe nga historiku i ndryshimeve të subjektit.

Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme sipas lëndës në përputhje me nenin 17 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, për arsye se veprimi dhe mori masa organi kompetent me të cilën është tejkalluar situata së cilës i referohet denoncimi.

Duke pasur parasysh të theksuaren më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/19), vendosi si në dispozitën të këtij vendimi.

Përgatiti: M.r.B.K.SH, Këshilltar  
Miratoi: M.r.SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHETËTOR  
PËR PARANDALIMIN E  
KORRUPSIONIT  
Kryetar  
Biljana Ivanovska